

PËR

HAPJEN E FAZËS SË APLIKIMEVE PËR KONKURRIM PËR NDJEKJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “SIGURIA DHE HETIMI”, CIKLI I PARË “BACHELOR”, NË AKADEMINË E SIGURISË, PËR VITIN AKADEMIK 2026–2027

Mbështetur në pikën 1, pikën 2 shkronja “c”, dhe “l” të nenit 55, nenit 69, nenit 73, neneve 85-89, të Ligjit Nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”; nenet 54-66 të Rregullores së Policisë së Shtetit të miratuar me VKM nr.112, datë 24.02.2025; VKM nr. 881, datë 28.10.2020, “Për statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm i Arsimit të Lartë në fushën e Rendit e të Sigurisë Publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, i ndryshuar; në pikën 1, germa “a” dhe pikat 5, 6 dhe 7, të VKM nr. 436, datë 03.06.2020, “Për caktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në Programet e studimeve të Ciklit të Parë dhe në Programet e Integruara të studimeve të Ciklit të Dytë ose Transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”; Urdhërin e përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, nr.108, datë 15.06.2026 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2026 – 2027”; Urdhërin nr.129, datë 01.08.2025, të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për përcaktimin e moshës për kategoritë e pranimit në Rolet Policore”; Procedurën Standarte të Punës, “Për zhvillimin e fazave të vlerësimit dhe testimit për pranimin në rolin zbatues dhe rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit”, miratuar me urdhër nr.609, datë 16.04.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Vendimin nr. 40, datë 29.04.2026, të Senatit Akademik, “Për miratimin e kuotave të programit në ciklin e parë “Bachelor” dhe ciklin e dytë “Master Profesionale” e “Master Shkencor”, për vitin akademik 2026-2027; Vendimin nr. 143, datë 29.04.2026, të Senatit Akademik, “Për miratimin e kriterëve të përgjithshme të pranimit të studentëve, në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Siguria dhe hetimi”, në Akademinë e Sigurisë”;

Me qëllim plotësimin e nevojave për burime njerëzore në rolin e parë drejtues, në strukturat e Policisë së Shtetit, nëpërmjet një procesi konkurrimi të drejtë, të paanshëm dhe transparent, sipas parimit të shanseve të barabarta, mosdiskriminimit dhe meritës,

URDHËROJ:

1. Hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim, për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë i studimeve “Bachelor”, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë, për **60 kuota** të lira, për shtetasit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë.
2. Administrator i procesit të konkurrimit do të jetë Drejtues i Parë Alfred Çepe, me detyrë Drejtor/Dekan, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë.

PROCEDURAT QË NDIQEN PËR SHTETASIT QË KANË PËRFUNDUAR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

I. KRITERET DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT E REGJISTRIMIT

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për të ndjekur studimet pranë Akademisë së Sigurisë, në programin “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë i studimeve “Bachelor”, **me kohëzgjatje 3 vite akademike**, shtetasit të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë shtetas shqiptarë;
 - b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore;
 - d) Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, struktura të tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore;
 - e) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm të lartë brenda ose jashtë vendit, të njohur ose ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në Republikën e Shqipërisë;
 - f) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
 - g) Të zotërojnë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
 - h) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - i) Të kenë filluar procedurat për t’u pajisur me dëshmi të aftësisë për drejtimin e automjetit të tipit “B”;
 - j) Të plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe integritetit;
 - k) Të ketë notën mesatare të arsimit të mesëm të lartë, **jo më pak se 6.5**;
 - l) Të jetë në moshën deri 30 vjeç në ditën e fillimit të vitit akademik;
 - m) Të ketë gjatësinë trupore **jo më pak se 170 cm për meshkuj dhe jo më pak se 160 cm për femra**;

2. Shtetasit, të cilët përfundojnë arsimin e mesëm të lartë, i nënshtrohen procedurave sipas agjendës së mëposhtme:

Nr	Aktiviteti që do të kryhet	Personi/institucioni përgjegjës	Periudha
1.	Aplikim në portalin U-Albania nëpërmjet formularit <i>online</i> të aplikimit, duke zgjedhur programin “Siguria dhe Hetimi”.	Aplikantët	27 korrik – 01 gusht 2026
2.	Nga portali U-Albania, shkarkohet lista e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”.	Akademia e Sigurisë	4 gusht 2026
3.	Afishim në mjediset e Akademisë, si dhe në ëbsite-in e Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, i listës së aplikantëve të cilët kanë aplikuar për programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”, duke përcaktuar fazat dhe datat e zhvillimit të testeve.	Akademia e Sigurisë	5 gusht 2026
4.	Regjistrimi i aplikantëve dhe dorëzimi i dokumentacionit fillestar.	Komisioni i Pranimit	05 - 07 gusht 2026
5.	<u>Aplikantët i nënshtrohen procesit të:</u> a) <i>Vlerësimi administrativ;</i> b) <i>Verifikimit të integritetit dhe besueshmërisë për tu bërë pjesë e Policisë së Shtetit;</i> c) <i>Kontrollit shëndetësor;</i> d) <i>Testit fizik;</i> e) <i>Intervista me gojë</i> f) <i>Testit psikologjik.</i> g) <i>Marrjen dhe verifikimin e gjurmëve të gishtave</i>	Akademia e Sigurisë	05 – 21 gusht 2026
6.	Vlerësimi administrativ	Komisioni i vlerësimit	05 – 07 gusht 2026
7.	Zhvillimi i testit fizik	Komisioni i vlerësimit	08 – 11 gusht 2026
8.	Zhvillimi i intervistës me gojë dhe testit psikologjik	Komisioni i Vlerësimit	10 – 13 gusht 2026
9.	Zhvillimi i kontrollit mjekësor	Komisioni mjekësor	14 – 19 gusht 2026
10.	Administrimi i vërtetimeve të besueshmërisë	Komisioni i Pranimit	Brenda datës 19 gusht 2026
11.	Marrja e gjurmëve të gishtave	Instituti i Policisë Shkencore	14 – 19 gusht 2026
12.	Hartimi i listës së rezultateve sipas rendit zbritës	Komisioni i Pranimit	22 gusht 2026

Nr	Aktiviteti që do të kryhet	Personi/institucioni përgjegjës	Periudha
13.	Afishimi dhe ngarkimi në portalin U-Albania i listës së rezultateve sipas rendit zbritës, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre të maturës.	Komisioni i Pranimit	22 gusht 2026
14.	Ankimimi	Aplikantët	24-25 gusht 2026
15.	Shqyrtimi i ankesave të aplikantëve	Komisioni i Ankimimit	25-26 gusht 2026
16.	Publikimi në portalin U-Albania, i listës së aplikantëve fitues në rend zbritës.	Akademia e Sigurisë	26 gusht 2026
17.	Regjistrimi dhe dorëzimi i dokumentacionit përfundimtar nga aplikantët e shpallur fitues.	Aplikantët Komisioni i Pranimit	26 gusht – 08 shtator 2026

- Aplikantët që duan të ndjekin studimet në Akademinë e Sigurisë, në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, “Siguria dhe Hetimi”, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të këtij urdhri, të publikuara dhe në portalin U-Albania, duhet të aplikojnë në portalin U-Albania në periudhën **27 korrik – 01 gusht 2026**, nëpërmjet formularit *online* të aplikimit, duke zgjedhur programin “Siguria dhe Hetimi”.
- Aplikantët gjatë procesit të aplikimit duhet të shkarkojnë nga faqja zyrtare e Policisë së Shtetit formularin e aplikimit, kërkesën model tip, formularin e vetëdeklarimit, si dhe skedën shëndetësore, bashkëlidhje e këtij urdhri, të cilat i dorëzojnë në momentin e regjistrimit në Akademinë e Sigurisë. Për rubrikat e kontrollit të përgjithshëm, skeda shëndetësore të plotësohet pranë qendrave shëndetësore ku aplikanti ka vendbanimin, *(përveç pikës 10 të kësaj skede e cila plotësohet në Sektorin e Profilaksi Mjekimit)* dhe dorëzohet nga aplikanti pranë Komisionit, në momentin e zhvillimit të kontrollit shëndetësor.
- Komisioni i Pranimit më datën **04 gusht 2026** shkarkon nga portali U-Albania listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit “Siguria dhe hetimi”.
- Komisioni i Pranimit, më datën **05 gusht 2026**, afishon në mjediset e saj, si dhe në Eëbsite-in e Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, listën e aplikantëve të cilët kanë aplikuar për programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”, si dhe datën e zhvillimit të testeve dhe kontrollit shëndetësor.
- Komisioni i Pranimit, brenda periudhës **05 – 07 gusht 2026**, bën regjistrimin e aplikantëve si dhe vlerësimin administrativ të tyre, për të verifikuar nëse ata plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, për praninë në Akademinë e Sigurisë, si dhe kanë plotësuar formularët në mënyrën e duhur.

8. Aplikantët në momentin e regjistrimit pranë Akademisë së Sigurisë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✓ *Kërkesën model tip për regjistrim;*
- ✓ *Dokumentacion që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë, të noterizuar;*
- ✓ *Formularin e aplikimit për punësim në strukturat e policisë;*
- ✓ *Formularin e vetëdeklarimit;*
- ✓ *Fotokopje të kartës së identitetit;*
- ✓ *Certifikatë familjare;*

9. Nëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se aplikanti nuk plotëson një nga kriteret e përcaktuara, ai s'kualifikohet nga procesi i konkurrimit. Aplikanti njoftohet nëpërmjet email-it të evidentuar nga ana e tij në formularin e aplikimit, në lidhje me arsyet e skualifikimit.

10. Komisioni i Pranimi harton listat e aplikantëve që plotësojnë kriteret, të ndara në nivel qarku dhe i dërgon ato pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

11. Brenda datës **07 gusht 2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dërgon listën e aplikantëve, pranë Drejtorive Vendore të Policisë ku aplikanti ka vendbanimin, me qëllim kryerjen e verifikimit të besueshmëris dhe integritetit.

12. Verifikimi i besueshmërisë së aplikantëve është një proces i verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruara nga aplikantët, në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të administruara nga Policia e Shtetit, si dhe Institucionet e tjera shtetërore shqiptare apo të huaja.

13. Verifikimi i besueshmërisë së aplikantëve bëhet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Procedurën Standarde "Rastet, modalitetet dhe strukturat që hartojnë vërtetimin e besueshmërisë", të miratuara me urdhër nr. 923 datë 23.06.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, **brenda datës 19 gusht 2026**. Drejtoritë Vendore të Policisë, jo më vonë se **data 21.08.2026**, të dërgojë vërtetimet e besueshmërisë pranë Komisionit të Pranimi në Akademinë e Sigurisë.

II. PROCESI I VLERËSIMIT, KONTROLLIT DHE TESTIMIT

1. Aplikantët i nënshtrohet procesit të vlerësimit, testimit dhe kontrollit, i cili përfshin:

Nr	Lloji i vlerësimit/kontrollit	Pesha specifike	Periodha
1	Vlerësimin sipas notës mesatare të shkollës së mesme të lartë	50 % të vlerësimit të përgjithshëm; (5 pikë për çdo notë. Psh. Nota mesatare 8 x 5 pikë = 40 pike)	05 – 06 gusht 2026
2	Testim fizik	30% të vlerësimit të përgjithshëm	08 – 11 gusht 2026
3	Intervista me gojë	20% të vlerësimit të përgjithshëm	10 – 13 gusht 2026
4	Testimit psikologjik	Kalues/jo kalues	10 – 13 gusht 2026

IV. KOMISIONI I PRANIMIT DHE VLERËSIMIT

1. Me qëllim mbarëvajtjen e procesit të pranimi, në programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ngrihet Komisioni i Pranimi, Komisionet e Vlerësimit të fazave të testeve dhe sekretaria teknike.
2. Komisioni i Pranimi ka për detyrë:
 - ✓ Të bëjë regjistrimin e aplikantëve;
 - ✓ Të vlerësojë e shqyrtojë dokumentacionin si dhe plotësimin e kriterëve të aplikantëve;
 - ✓ Të bëjë vlerësimin e notës mesatare sipas peshës specifike në raport me rezultatin e përgjithshëm;
 - ✓ Të administrojë rezultatet e Komisioneve të Vlerësimit të testit fizik, intervistës me gojë, testit psikologjik dhe kontrollit mjekësor;
 - ✓ Të vlerësojë plotësimin e kriterit të besueshmërisë dhe integritetit të aplikantëve;
 - ✓ Të përlllogarisë dhe nxjerrë rezultatet përfundimtare të aplikantëve;
 - ✓ Të marrë vendim për aplikantët fitues dhe jo fitues si dhe të bëjë shpalljen e rezultateve përfundimtare.
3. Komisionet e Vlerësimit bëjnë vlerësimin e aplikantëve në testin fizik, intervistën me gojë, testin psikologjik dhe kontrollin mjekësor.

V. ANKIMIMI

1. Aplikanti ka të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në adresën e email-it burimet.njerezore@asp.gov.al ose fizikisht në sekretarinë e Drejtorisë së Burimeve Njerezore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas afateve si vijon:
 - ✓ Për rezultatet e arritura në fazat e testimit/ skualifikimin e tij, **brenda 2 ditëve** nga marrja e njoftimit;
 - ✓ Për renditjen në listën e publikuar në U-Albania, në datat **24-25 gusht 2026**.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave përbëhet nga:

1. Drejtues i Lartë Sokol Bizhga	<i>Zëvendës drejtori i Përgjithshëm</i>	<i>Kryetar</i>
2. Drejtues Anisa Duçkollari	<i>Drejtori i Burimeve Njerezore</i>	<i>Anëtar</i>
3. Drejtues Sabri Jacaj	<i>Drejtori i Standardeve Profesionale</i>	<i>Anëtar</i>
3. Komisioni Shqyrtimit të Ankesave asistohet nga sekretaria teknike e përbërë nga specialistë të Drejtorisë të Burimeve Njerezore.
4. Trajtimi i ankesave bëhet në përputhje me Procedurën Standarde të Punës, “Për zhvillimin e fazave të vlerësimit dhe testimit për pranimin në rolin zbatues dhe rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit”, miratuar me urdhër nr.609, datë 16.04.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5	Kontrolli shëndetësor	I aftë/jo i aftë	14 – 19 gusht 2026
---	-----------------------	------------------	-----------------------

- Testimi fizik, intervista me gojë, testi psikologjik dhe kontrolli shëndetësor, kryhen sipas rregullave të përcaktuara në Procedurën Standarte të Punës, “Për zhvillimin e fazave të vlerësimit dhe testimit për pranimin në rolin zbatues dhe rolin e parë drejtues në Policinë e Shtetit”, miratuar me urdhër nr.609, datë 16.04.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- Aplikantët njihen me rezultatet e testimit kundrejt nënshkrimit brenda ditës kur ata zhvillojnë procesin e testimit.
- Komisioni i Pranimit harton listat e aplikantëve që janë kualifikuar në të gjitha fazat e testimeve dhe e dërgon pranë Institutit të Policisë Shkencore, me qëllim ndjekjen e procedurave për marrjen dhe verifikimin e gjurmëve të gishtave.
- Instituti i Policisë Shkencore të marrë masa për planifikimin me shërbim të një Ndhmës specialisti, laborant kriminalist, në datat 14 – 19 Gusht 2026, i cili të marrë gjurmë e gishtave të aplikantëve, në ambjentet e Akademisë së Sigurisë (*Qendra Shëndetësore*).
- Pas kryerjes së procedurave për marrjen e gjurmëve daktiloskopike të aplikantëve, kryhet krahasimi në sistemin “Afis/Apis Papilon 9”, nga Instituti i Policisë Shkencore. Marrja e gjurmëve daktiloskopike bëhet sipas procedurave standarde, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- Aplikantët, që pas krahasimit të gjurmëve daktiloskopike rezultojnë me probleme në sistemin “Afis/Apis Papilon 9” i nënshtrohen procedurave të mëtejshme të verifikimit dhe kontrollit nga strukturat e hetimit të krimeve ku janë evidentuar gjurmët.
- Instituti i Policisë Shkencore, jo më vonë se **data 21.08.2026**, të dërgojë rezultatet e krahasimit të gjurmëve daktiloskopike nominalisht për secilin aplikant, pranë Komisionit të Pranimit në Akademinë e Sigurisë.

III. NXJERRJA DHE PUBLIKIMI I REZULTATEVE

- Komisioni i pranimit, më datën **22 gusht 2026** harton listën e rezultateve të aplikantëve, shqyrton vërtetimet e besueshmërisë dhe informacionin e ardhur nga Instituti i Policisë Shkencore për secilin aplikant dhe merr vendim për aplikantët që kualifikohen dhe shpallen fitues, si dhe aplikantët të cilët nuk janë fitues.
- Shpallen fitues, vetëm aplikantët e renditur në liste sipas rezultateve në rend zbritës, brenda **60 kuotave** të shpallura për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara, kanë kaluar me sukses fazat e testimeve, janë të besueshëm, nuk kanë pengesa ligjore për pranimin në rolin e parë drejtues të Policisë së Shtetit.
- Komisioni i Pranimit më datën **22 gusht 2026**, afishon dhe publikon listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Akademia e Sigurisë ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

5. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të ankesave merr vendim dhe ja vwn dispozicion Komisionit të Pranimi, me qëllim vijimin e fazave të procesit të konkurrimit procesi. Njoftimi mbi vendimin e komisionit bëhet nga sekretaria teknike e tij.

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE DHE REGJISTRIMI I APLIKANTËVE


6. Pas përfundimit të procesit të ankimimit, Komisioni i Pranimi më datën **26 gusht 2026** bën publikimin në portalin U-Albania, të listës së aplikantëve fitues në rend zbritës.
7. Më datën **26 gusht – 08 shtator 2026**, Komisioni i Pranimi bën regjistrimin e aplikantëve fitues. Aplikantët fitues në momentin e regjistrimit dorëzojnë dokumentacionin shtesë, që përfshin:
 - a) *Certifikatë të gjendjes gjyqësore;*
 - b) *Vërtetim që është i regjistruar për marrjen e dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “B”;*
 - c) *Vërtetim nga gjykata që nuk është në gjykim për veprë penale;*
 - d) *Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;*
 - e) *Vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;*
8. Nëse pas përfundimit të raundit të parë, nuk plotësohen kuotat e lira për konkurrim, procesi i aplikimit dhe regjistrimit rifillon sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Urdhërin e përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, nr.108, datë 15.06.2026 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2026 – 2027”.
9. Sektori i Komunikimit me Median dhe Publikun të bëjë publikimin në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit të aksesueshme nga çdo shtetas, si dhe në median e shkruar e atë vizive të këtij urdhri, formularin e aplikimit, formularin e vetëdeklarimit, kërkesën model tip, skedën shëndetësore, si dhe video të testimit fizik që do t’i nënshtrohen aplikantët.
10. Departamenti për Shërbimet Mbështetëse të marrë masa për të siguruar infrastrukturën e nevojshme, për akomodimin e **60 aplikantëve** të shpallur fitues në procesin e konkurrimit.
11. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit draft-urdhërin për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për vazhdimin e studimeve në programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”, në Akademinë e Sigurisë.
12. Procesi i pranimi në Policinë e Shtetit menaxhohet dhe koordinohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Akademia e Sigurisë.
13. Në momentin e fillimit të studimeve, aplikanti nënshkruan kontratën me titullarin e Akademisë së Sigurisë. Në kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet gjatë shkollimit, si dhe qëndrimit në detyrë në strukturat policore, jo më pak se 3 (tre) vite, pas përfundimit të studimeve.

14. Shtetasit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, që pranohen të vazhdojnë studimet me kohë të plotë në ciklin e parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, në momentin e fillimit të studimeve trajtohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 09.01.2025 “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore dhe përcaktimin e kriterëve e të procedurave për dhënien e shpërblimeve për punonjësit e Policisë së Shtetit”, i ndryshuar.
15. Monitorimi i procesit të pranimit në Policinë e Shtetit të kryhet nga Drejtoria e Standardeve Profesionale.
16. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin e Protokollit dhe Ceremonive të bëjë njoftimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, si dhe misionëve policore që asistojnë Policinë e Shtetit, si EU4LEA dhe Programi ICITAP, para fillimit të secilës fazë të procesit të pranimit.
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Akademia e Sigurisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Departamenti për Shërbimet Mbështetëse, Drejtoria e Standardeve Profesionale, Instituti i Policisë Shkencore, Sektori i Protokollit dhe Ceremonive, Sektori i Komunikimit me Median dhe Publikun dhe strukturat vendore të Policisë.
18. Me këtë urdhër të njihen të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.
19. Për kontrollin e zbatimit të këtij urdhri, ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Drejtues Madhor Skender HITA



FORMULARI I APLIKIMIT PËR PRANIM NË POLICINË E SHTETIT

(Ky formular plotësohet elektronikisht nga shtetasi/sja që aplikon)

KY APLIKIM BËHET PËR:

- ☐ Vazhdimin e studimeve në Kolegjin Profesional të Formimit Policor;
- ☐ Vazhdimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë, niveli "Bachelor";
- ☐ Vazhdimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë për shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve.
- ☐ Rikthim në Policinë e Shtetit
- ☐ Pranim në funksione të veçanta të Policisë së Shtetit në pozicionin e punës: (Shkruaj pozicionin për të cilin konkurron)

- ☐ Pranim në funksione ndihmëse të Policisë së Shtetit në pozicionin e punës:

Sqarim: Për pranim në funksione të veçanta dhe funksione ndihmëse të Policisë së Shtetit, aplikanti shkruan pozicionin për të cilin aplikon, ndërsa për rastet e tjera vendos shenjen "X" në fushën përkatëse.

1. INFORMACIONI PERSONAL

Emër Atësi Mbiemër:			
Datëlindja:			
Vendlindja:			
Gjinia:	Mashkull ☐	Femër ☐	
Jeni shtetas shqiptar:	Po ☐	Jo ☐	
Adresa e banimit:			
Email:			
Nr. i telefonit:			

2. ARSIMI (Vendosni në rend zbritës të gjithë nivelet e arsimit duke filluar nga arsimi i mesëm):

Niveli i arsimit (Arsim i mesëm i përgjithshëm / Arsim profesional/ Bachelor/ Master Profesional/Shkencor)	Profili (fusha e studimit/specializimi)	Periudha (vitin i fillimit dhe përfundimit të studimeve)	Institucioni arsimor Shkolla e mesme e Përgjithshme/ Shkolla e mesme Profesionale/Universiteti	Qyteti/Shteti

Niveli i arsimit (Arsim i mesëm i përgjithshëm /Arsim profesional/ Bachelor/ Master Profesional/Shkencor)	Profili (fusha e studimit/specializimi)	Periudha (vitin i fillimit dhe përfundimit të studimeve)	Institucioni arsimor Shkolla e mesme e Përgjithshme/ Shkolla e mesme Profesionale/Universiteti	Qyteti/Shteti

Sqarim: Shtetasit që kanë përfunduar arsimin jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të këtë bërë njohjen e diplomës pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

3. PËRVOJA E PUNËS NË FUSHËN PËR TË CILËN KONKURRON:

Periudha (data/muaji/viti i fillimit dhe përfundimit të punësimit)	Pozicioni	Institucioni

4. GJUHA E HUAJ

Gjuha e huaj	Institucioni që e ka lëshuar

5. LEJA E DREJTIMIT

Tipi	Nr. i Lejes së Drejtimit	Lëshuar nga	Data e vlefshmërisë

6. DOKUMENTACIONI: (vendos shenjën "X" për secilin dokument që është bashkëlidhur me formularin)

Nr.	Dokumentacioni	
1.	Formulari vetëdeklarimi (lidhja 2)	☐
2.	Diplomën dhe listën e notave të noterizuara	☐
3.	Fotokopje të kartës së identitetit	☐
4.	Certifikatë e gjendjes gjyqësore	☐

5.	Certifikatë familjare	☐
6.	Vërtetim nga gjykata që nuk është në gjykim për veprë penale;	☐
7.	Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;	☐
8.	Vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	☐
9.	Vërtetim që është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht	☐
10.	2 Fotografë me përmasa 4 cm x 6 cm	☐
11.	Vërtetim për përvojë në punë në profesion	☐
12.	Certifikatë për zotërimin e gjuhës së huaj	☐
13.	Diplomën dhe listën e notave të noterizuara të Arsimit shtesë	☐
14.	Trajnime	☐
15.	Referenca të punëdhënësve të mëparshëm	☐
16.	Dëshmi e aftësisë së drejtimit të automjetit	☐
17.	Mandat pagesa e aplikimit	☐

Sqarim: Lista e dokumenteve të mësipërme është e përgjithshme dhe përfshin të gjitha llojet e pranimeve në Policinë e Shtetit. Aplikantët dorëzojnë vetëm dokumentet që kërkohen në momentin e shpalljes së aplikimeve.

Deklaroj dhe mbaj përgjegjësi ligjore mbi vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura bashkëlidhur këtij formulari dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Tiranë, më datë ____ . ____ .202__

Emër, Mbiemër, Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË STRUKTURAT E POLICISË

- ✚ Ky formular pranohet nga strukturat vendore apo qendrore të burimeve njerëzore, vetëm nëse është plotësuar në mënyrë elektronike nga shtetasi/sja i cili aplikon për tu pranuar apo rikthyer në Policinë e Shtetit.
- ✚ Formulari është i detyrueshëm për tu plotësuar në të gjitha rastet e rikthimit dhe pranimit në Policinë e Shtetit;
 - Në rastet e rikthimit në Policinë e Shtetit formulari plotësohet në momentin e dorëzimit të kërkesës për rikthim pranë strukturave të burimeve njerëzore;
 - Në rastet e pranimeve nëpërmjet konkurremeve, ky formular plotësohet në momentin e aplikimit.
- ✚ Të gjitha rubrikat në formular duhet të jenë të plotësuara;
- ✚ Personi që plotëson formularin shkruan emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në vendin e caktuar në fund të çdo faqeje.
- ✚ Ky formular plotësohet në kuadër të verifikimit të integritetit të shtetasit i cili kërkon të punësohet në strukturat e Policisë së Shtetit;
- ✚ Të dhënat e plotësuara në këtë formular janë objekt verifikimi i Policisë së Shtetit. Nëse gjatë verifikimit konstatohet se janë deklaruar të dhëna të rreme, shtetasi ndërpret marrëdhëniet juridike të punës me Policinë e Shtetit.

KAPITULLI I – TË DHËNAT PERSONALE

PJESA 1: TË DHËNA IDENTIFIKUESE

1. Ju lutem plotësoni të dhënat tuaja në mënyrë të saktë ashtu siç është i regjistruar në gjendjen civile.

Emri:

Atësia:

Mbiemri:

Gjinia:

☐ Femër ☐ Mashkull

Data/Muaji/viti i lindjes:

FOTO

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Vendi i lindjes:

Shteti i lindjes

Shtetësia:

Numri Personal:

Statusi Civil:

☐ i/e martuar	☐ bashkëjetues/e	☐ i/e divorcuar	☐ i/e ve	☐ i/e pamartuar
--------------------------------------	---	--	---------------------------------	--

2. A keni pasur emër apo mbiemër tjetër më parë?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....

3. A jeni njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që keni pasur apo keni të regjistruar në gjendjen civile?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....

4. A keni pasur apo keni shtetësi tjetër?

Jo ☐

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

5.A keni adresë e-maili?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni adresën zyrtare të e-mailit, e cila do të përdoret për qëllim njoftimi gjatë procesit. Ju lutem jepni të gjitha adresat e tjera alternative të e-mailit.

.....
.....
.....

6. A keni nr. Tel fiks?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni numrin e telefonit së bashku me prefiksin.

.....
.....
.....

7. Numri/at e celularit që përdorni

.....
.....

8. Specifikoni numrin/at e celularit në emrin tuaj por që nuk përdoren nga ju, si dhe emrin e përdoruesit dhe lidhjen që keni me këtë të fundit.

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

.....
.....

9. Dokumentet e identifikimit që keni aktualisht:

PASAPORTA DHE KARTA E IDENTITETIT								
	Numri i Dokumentit	Data e lëshimit			Vlefshmëria			Institucioni lëshues i dokumentit
		Dita	Muaji	Viti	Dita	Muaji	Viti	
PASAPORTË								
KARTË IDENTITETI – ID								

1. Jepni adresën e plotë të vendbanimit.

(Adresë vendbanimi është adresa e banesës, në të cilën jetoni zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik.)

.....
.....
.....
.....

2. A keni adresë tjetër vendbanimi?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Historiku i adresave të vendbanimit brenda ose jashtë vendit për 10 vitet e fundit (sipas rendit kronologjik)

*Përfshihen: Adresat tuaja brenda apo jashtë Republikës Shqipërisë;
 Adresat e vendeve në të cilat keni jetuar për arsye studimesh/pune;
 Adresa të tjera tek të cilat keni jetuar përkohësisht (Më shumë se 2 muaj pa ndërprerje)*

Vendosni të gjithë historikun tuaj të adresave pa lënë periudha kohore boshe.

Data e fillimit		Data e largimit		Adresa e plote e vendbanimit	Vendi/Shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti		
/		Aktualisht			
/		_/_			
/		_/_			
/		_/_			
/		_/_			
/		_/_			

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Data e fillimit		Data e largimit		Adresa e plote e vendbanimit	Vendi/Shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti		
/	_/_				
/	_/_				

PJESA 3 TË DHËNAT PËR ARSIMIMIN DHE KUALIFIKIMET

1. Jepni detaje për arsimimin duke filluar nga shkolla e mesme

Data e fillimit		Data e përfundimit		Emri i plotë i institucionit ku keni ndjekur studimet	Titulli i fituar apo teza e mbrojtur	Adresa e plotë e institucionit	Vendi/Shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti				
/	_/_						
/	_/_						
/	_/_						

_____/_____

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Data e fillimit		Data e përfundimit		Emri i plotë i institucionit ku keni ndjekur studimet	Titulli i fituar apo teza e mbrojtur	Adresa e plotë e institucionit	Vendi/Shteti
Muaji	Viti	Muaji	Viti				
/		/					
/		/					
/		/					

PJESA 4 TË DHËNA PËR PUNËSIMIN

Jepni detaje për punësimin dhe për periudhën e papunësisë për 10 vitet e fundit, pa lënë hapësira kohore të papërfshirë: *(Nese nuk keni historik punësimi vendos N/A)*

Periudha punësimit përfshin:

- Të gjithë periudhën e paguar të punësimit
- Vetëpunësimit/biznesit familjar, personal
- Intershops
- Punë të papagueshme /vullnetare

Periudha e papunësisë përfshin:

- të gjitha hapësirat apo pauzat ndërmjet punësimit.
- (Shkruaj i papunë në kolonën funksioni)

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
/		Aktualisht						

_____/_____

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni	Funksion i	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
/	_/_							
/	_/_							
/	_/_							
/	_/_							
/	_/_							

PJESA 5 TË DHËNA PËR SIGURINË

1. A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....

.....

.....

.....

2. A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një veprë penale?

_____ / _____

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

3. A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

4. A jeni shoqëruar ndonjëherë nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

5. A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHETIT

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

6. A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

6. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

7. A keni dijeni nëse ndonjë nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë/ dyshohet për përfshirje në veprimtari që lidhen me veprimtari kriminale?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

.....
.....
.....
.....

Me termin “anëtar familjeje” do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, fëmijët madhorë, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

8. A keni pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

9. A jeni në dijeni nëse ndonjë nga anëtarët e familjes suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

10. A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar?

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

11. A keni dijeni se një anëtar i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

12. Gjate 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

13. A keni kërkuar azil politik në ndonjë shtet?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

.....
.....
.....
.....

14. A keni kryer shkelje sigurie, apo në mënyrë të përsëritur keni nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo keni tentuar dhe keni arritur të kryeni aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

15. A keni vuajtur ndonjëherë nga çrregullime mendore kronike?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

16. A keni qenë apo jeni përdorues i lëndëve narkotike?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHETIT

17. A keni varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje

.....
.....
.....
.....

18. Keni ndonjë të afërm të punësuar aktualisht në Policinë e Shtetit?

Jo ☐

Po ☐ » Jepni detaje për emrin, pozicionin e punës dhe lidhjen që keni me të punësuarin.

.....
.....
.....
.....

Emri, Atësia, Mbiemri/nënshkrimi

/ _____ /

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHTETIT

DEKLARATË

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në formularin e vetëdeklarimit janë të sakta dhe të vërteta.

Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i formularit të vetëdeklarimit sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me Policinë e Shtetit.

_____, mē ____/____/20____

(Emër Atësi Mbiemër)

Nënshkrimi

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR PUNËSIM NË POLICINË E SHETIT

DEKLARATË

Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e _____, i/e vitlindjes _____, lindur në _____ dhe banues/banuese në _____, me kombësi _____ dhe shtetësi _____, aktualisht me punë pranë _____, me detyrë _____, me vullnetin tim të lirë;

DEKLAROJ SE:

- Jap pëlqimin që të mbledhen të dhëna dhe të kryhet procedura e verifikimit të të dhënave të deklaruara në këtë formular vetëdeklarimi.
- Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në "Formularin e vetëdeklarimit", të trajtohen nga personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllimet e ligjshme.
- Jam i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i formularit të vetëdeklarimit, mund të sjellë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me policinë e Shtetit apo ndërprerjen e procesit të aplikimit dhe konkurrimit në çdo fazë të tij.

_____, me _____.20__

DEKLARUESI

(_____)

/ _____ /

Emri, Mbiemri

Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
Sektori i Profilaksi Mjekimit

SKEDË MJEKËSORE
PËR EFEKTIVËT E POLICISË SË SHTETIT

EMRI: _____ Nr. letërnjoftimit: _____

ATESIA: _____ Vendbanimi: _____

MBIEMRI: _____

MOSHA: _____

1. Mjeku i familjes:

Nr. Rregjistri _____

Anamnesis vitae: _____

Ekzaminimi Klinik: _____

Kqyrja fizike: _____

Mjeku: _____

2. Shërbimi i Oftalmologjisë:

Nr. rregjistri _____

a) Syri i djathtë: _____

b) Syri i majtë: _____

c) Pamje me sy te lirë: _____

Ekzaminimi oftalmologjik: _____

Mjeku: _____

3. Shërbimi ORL:

Nr. rregjistri _____

a) Aftësia veshi i djathtë _____

b) Aftësia veshi i majtë _____

Ekzaminimi ORL paraqet: _____

Mjeku: _____

4. Shërbimi i Pneumologjisë:

Nr. rregjistri _____

a) Ekzaminimi pulmonar _____

b) Prova funksionale respiratore _____

c) Mantu: _____

Mjeku: _____

5. Shërbimi i Kardiologjisë:

Nr. rregjistri _____

a) Vizita kardiologjike: _____

b) Tensioni arterial: _____

c) Elektrokardiograma: _____

Ekzaminime të nevojshme: _____

Mjeku: _____

6. Shërbimi i Kirurgjisë:

Nr. rregjistri _____

a) Mungesa fizike, ortopedike e gjymtime: _____

b) Dëmtime raketike post traumatike: _____

Ekzaminime të nevojshme: _____

Mjeku: _____

7. Shërbimi i Imazherisë:

Nr. rregjistri _____

a) ECHO abdominale: _____

b) Ekzaminime të tjera: _____

Mjeku: _____

8. Shërbimi i Neurologjisë:

Nr. rregjistri _____

Vizitë neurologu _____

Mjeku: _____

9. Shërbimi i Psikiatrisë:

Nr. rregjistri _____

Vizitë Psikiatri _____

Mjeku: _____

10. Analiza Laboratorike:

Nr. rregjistri _____

- a) Gjak komplet: _____
- b) Urinë komplet: _____
- c) Glicemia: _____
- d) Bilirubina totale: _____
- e) Transaminazat SGPT: _____
- f) Grupi i gjakut: _____
- g) Rhexus Faktor: _____
- h) HBsAg: _____
- i) Testi i drogës _____

Laboranti: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 1908 Prot. Tiranë, më 15 . 06 .2026

Nr. 1908 Prot. Tiranë, më 01 . 06 .2026

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 108 , Datë 15 / 06 /2026

**-- PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2026 – 2027**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar,

URDHËROJ

1. Miratimin e kalendarit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2026 – 2027”, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Për Qendrën Ndërinstitucionale



të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtor i Përgjithshëm

Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Aida MYRTO

Z. Arjan XHELAIJ



SHTOJCA NR. 1

Kreu II Procedurat e Aplikimit dhe regjistrimit të Kandidatëve në Programet e Studimeve me Karakter Profesional, në Programet e Studimeve të Ciklit të Parë dhe në Programet e Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë	
A. Procedurat e aplikimit. Raundi i parë	
A. Procedurat e aplikimit Raundi i parë, pika 4	Kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Pagesa kryhet deri në 24 korrik 2026 . Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritetë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer brenda datës 25 korrik 2026 , në portalin U-Albania.
A. Procedurat e aplikimit Raundi i parë, pika 5	Në periudhën 27 korrik - 01 gusht 2026 , kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit, do të aplikojnë në portalin U-Albania nëpërmjet formularit <i>online</i> të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL, duke zgjedhur deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit që ofrohen nga IAL, për vitin akademik përkatës.
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve, Raundi i Parë	
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve Raundi i parë, pika 1	Brenda datës 1 Korrik 2026 QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve, që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z, sipas të dhënave të përcaktuara në pikën 1, të kreu II/B, të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve, Raundi i parë, pika 2	Brenda datës 20 korrik 2026 , QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, të dhënat për çdo kandidat, sipas përcaktimeve të pikës 2, të kreut II/B të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve Raundi i parë, pika 3	Në datat 4 gusht 2026 , IAL që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, shkarkojnë nga portali U-Albania listën e kandidatëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes	Në datën 05 gusht 2026 , IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre

së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve Raundi i parë, pika 4	dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, listat e kandidatëve dhe datën e zhvillimit të konkursit. Në periudhën 06 - 20 gusht 2026 do të zhvillohen konkurset e pranimit.
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve Raundi i parë, pika 5	Në datën 17 gusht 2026 , IAL mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, të dhënat për çdo kandidat, sipas përcaktimeve të pikës 5, të kreut II/B, të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
B. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve Raundi i parë, pika 7	Brenda datës 21 gusht 2026 , IAL, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 22 gusht 2026 , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.
C. Procesi i Regjistrimit, Raundi i parë	
C. Procesi i Regjistrimit Raundi i parë, pika 2	Në datat 26 gusht deri 08 shtator 2026 (7 faza 48-orëshe; 26-27; 28-29; 30-31; 01-02; 03-04; 05-06 dhe 07-08), kandidatët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës, në sekretariatë mësimore të IAL-ve, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
C. Procesi i Regjistrimit Raundi i parë, pika 6	Në rast se, pas çdo faze, konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe në listë dhe shpallen fitues të rinj, të cilët regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 08 shtator 2026 .
C. Procesi i Regjistrimit Raundi i parë, pika 7	Brenda datës 18 shtator 2026 , RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara, në format shkresor dhe elektronik me të dhënat e përcaktuara në pikën 7, kreu II/C të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
D. Procesi i Çregjistrimit, Raundi i parë	
D. Procesi i Çregjistrimit Raundi i parë, pika 1	Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistrin e IAL-së, ka të drejtë të çregjistrohet në datat 09 shtator 2026 .
D. Procesi i Çregjistrimit Raundi i parë, pika 2	Sekretariatë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania, listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik brenda datës 12 shtator 2026 .
E. Procesi i Ankimit, Raundi i parë	
E. Procesi i Ankimit Raundi i parë, pika 1	Kandidati ka të drejtën e ankimit në IAL përkatëse në datën 24 gusht 2026 .

E. Procesi i Ankimit Raundi i parë, pika 2	IAL, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik, në portalin U-Albania, më datë 25 gusht 2026 , vendimet lidhur me ankimet e aplikantëve.
E. Procesi i Ankimit Raundi i parë, pika 3	Kandidati, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse është shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa është pranuar, ata duhet të regjistrohet nga programi i studimit (nëse është regjistruar) dhe të regjistrohet në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimi, në datën 11 shtator 2026 .
E. Procesi i Ankimit, Raundi i parë, pika 4	Kuotat e paplotësuara, në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL-ja në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël, të ofruara brenda së njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore. IAL njofton zyrtarisht MA për vendimin e Senatit Akademik mbi përshtatjen e kuotave të programit të studimit jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga data e përfundimit të afatit për regjistrim, për raundin e parë. Përshtatja e kuotave të paplotësuara nga IAL-të kryhet në datat 09-11 shtator 2026 dhe brenda kësaj periudhe njoftohet elektronikisht dhe zyrtarisht Ministria e Arsimit. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore MA njofton brenda datës 14 shtator 2026 IAL-të, RASH-in dhe QSHA-në, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimit të periudhës së aplikimeve për raundin e dytë.
F. Procedurat e Aplikimit, Raundi i dytë	
F. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, pika 1	Në periudhën 15 shtator - 17 shtator 2026 , do të kryhet procesi i aplikimit <i>online</i> për raundin e dytë në Portalin U-Albania.
F. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, pika 2	Deri më datë 11 shtator 2026 , nga drejtoritë e institucioneve të arsimit të mesëm të lartë, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, hidhen në sistemin SMIP të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.
F. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, pika 4	Kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në Bankat e Nivelit të Dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për

DEKLARATA E TE EKZAMINUARIT:

Nuk vuaj, nuk kam kaluar asnjë sëmundje kronike apo akute.

Deklaruesi: _____

VENDIMI I KOMISIONIT

Mbështetur në skedën mjekësore dhe në vizitat e kryera,

Komisioni vendosi :

ANËTAR

KRYETAR

ANËTAR

	këtë raund. Pagesa kryhet deri më 17 shtator 2026 . Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer brenda datës 17 shtator 2026 , në portalin U-Albania.
F. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, pika 6	Në datat 21 - 23 shtator 2026 , IAL-të, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 23 shtator 2026 , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.
G. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve, Raundi i Dytë	
G. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve, Raundi i dytë, pika 1	Brenda datës 11 shtator 2026 , QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, të dhënat për çdo kandidat, të përcaktuara në pikën 1, kreu II/G të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
G. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve, Raundi i dytë, pika 2	Në datën 18 shtator 2026 , IAL shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre të dhënat e përcaktuara në pikën 2, kreu II/G të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
G. Përcjellja e të Dhënave dhe Rezultateve, Procesi i Përlllogaritjes së Pikëve dhe Publikimi i Listave të Kandidatëve, Raundi i dytë, pika 4	Në datat 21 - 23 shtator 2026 , IAL afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së kandidatëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 23 shtator 2026 , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.
H. Procesi i Regjistrimit. Raundi i Dytë	
H. Procesi i Regjistrimit Raundi i dytë, pika 2	Në datat 25 shtator deri 04 tetor 2026 (5 faza 48-orëshe; 25-26; 27-28; 29-30, 01-02 dhe 03-04), kandidatët që kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL, me dokumentacion në sekretaritë mësimore, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
H. Procesi i Regjistrimit Raundi i dytë, pika 7	Brenda datës 19 tetor 2026 , RASH përcjell në QSHA, në format shkresor dhe elektronik, regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë, me të dhënat e përcaktuara në pikën 7, germa "H", kreu II të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.
I. Procesi i Çregjistrimit. Raundi i Dytë	

I. Procesi i Çregjistrimit Raundi i dytë, pika 1	Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet në datat 5 tetor 2026 .	
I. Procesi i Çregjistrimit Raundi i dytë, pika 2	Sekretaritetë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të kandidatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania, listën e kandidatëve të çregjistruar në format elektronik, brenda datës 07 tetor 2026 .	
J. Procedura e Aplikimit dhe Regjistrimit të Kandidatëve pas Raundit të Dytë		
J. Procedura e Aplikimit dhe Regjistrimit të Kandidatëve të pas Përfundimit të Raundit të Dytë, pika 1	Pas përfundimit të raundit të dytë IAL-të brenda datës 6 tetor 2026 përcaktojnë me vendim të Senatit Akademik, programet e studimit që nuk aktivizohen në atë vit akademik për shkak se nuk plotësojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar për aktivizimin e programit, sipas parashikimeve në aktet e brendshme të IAL-ve. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, QSHA-së dhe studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e tyre dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datat 07 tetor 2026 .	
J. Procedura e Aplikimit dhe Regjistrimit të Kandidatëve të pas Përfundimit të Raundit të Dytë, pika 2	Kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania që rezultojnë të pa regjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, në periudhën 08 – 21 tetor 2026 . Sekretaritetë mësimore kryejnë regjistrimin e këtyre studentëve brenda datës 21 tetor 2026 në portalin U-Albania.	
J. Procedura e Aplikimit dhe Regjistrimit të Kandidatëve të pas Përfundimit të Raundit të Dytë, pika 3	Brenda datës 14 nëntor 2026 , RASH përcjell në QSHA, në format shkresor dhe elektronik , regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë, me të dhënat e përcaktuara në pikën 3, germa “J”, kreu II të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, i ndryshuar.	
Kreu IV, V, VI, VII, VIII, IV/6		
Nr.	Referenca në Udhëzim	Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
KREU IV: PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË		
1	Kreu IV, pika 1	Kandidati që kërkon të ndjekë studimet në një program të dytë studimi apo të transferojë studimet, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në

		programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ka të drejtë të aplikojë deri në 5 (pesë) programe studimi pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat 01 – 12 shtator 2026 .
2	Kreu IV, pika 10	IAL-të shpallin në vende të dukshme listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi, brenda datës 17 shtator 2026 .
3	Kreu IV, pika 11	Çdo aplikim për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 23 shtator 2026 .
4	Kreu IV, pika 12	IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listën me renditjen e kandidatëve brenda datës 24 shtator 2026 .
5	Kreu IV, pika 14	IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 26 shtator 2026 .
6	Kreu IV, pika 15	Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore në datat 06 – 10 tetor 2026 . Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe në listë, brenda datës 17 tetor 2026 .
KREU V: PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATËVE ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN E JETIMIT, SI DHE TË KANDIDATËVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, , NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË		
7	Kreu V, pika 1	Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat 02 – 13 shtator 2026 , në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të.
8	Kreu V, pika 2	Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri më datën 12 shtator 2026 . Konkursët e pranimi zhvillohen më datë 16 shtator 2026 .

9	Kreu V, pika 10	IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre, si dhe për çdo program studimi që ofrojnë, ato publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Gjithashtu, IAL-të në datën 18 shtator 2026 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
10	Kreu V, pika 12	IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 26 shtator 2026 , duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
11	Kreu V, pika 13	Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues në periudhën 26 shtator 2026 deri më 03 tetor 2026 .
12	Kreu V, pika 14	Pas datës 4 tetor 2026 , sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.
13	Kreu V, pika 15	IAL-të brenda datës 10 tetor 2026 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.
KREU VI PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE ME DIPLOMË TË HUAJ TË SHKOLLËS SË MESME, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË		
14	Kreu VI, pika 1	Të gjithë kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë, që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas afateve të përcaktuara nga IAL-të, për çdo vit akademik, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja.
15	Kreu VI, pika 9	IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të sipas afateve të përcaktuara nga ana e tyre publikojnë në

		mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
16	Kreu VI, pika 11	IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, sipas afateve të përcaktuara nga ana e tyre, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
17	Kreu VI, pika 12	Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues sipas afateve të përcaktuara nga ana e IAL-ve. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.
18	Kreu VI, pika 13	Sipas afateve të përcaktuara nga ana e IAL-ve, sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.
KREU VII PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE/MASTER I ARTEVE”		
19	Kreu VII, pika 1	Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë, me përjashtim të programeve të integruara të ciklit të dytë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL, deri më datë 05 tetor 2026 .
20	Kreu VII, pika 3	Brenda datës 19 tetor 2026 IAL-të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
21	Kreu VII, pika 5	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve deri më 9 nëntor 2026 .
22	Kreu VII, pika 6	IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 13 nëntor 2026 .

KREU VIII PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË		
23	Kreu VIII, pika 1	Kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve apo të ndjekin një program të dytë studimi, me përjashtim të programeve të integruara të studimit, aplikojnë pranë IAL-ve, deri më 05 tetor 2026 .
24	Kreu VIII, pika 11	Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët deri në 06 tetor 2026 .
25	Kreu VIII, pika 15	IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 06 tetor 2026 .
26	Kreu VIII, pika 16	Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 12 tetor 2026 .
27	Kreu VIII, pika 17	IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 16 tetor 2026 .
28	Kreu VIII, pika 19	IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 13 tetor 2026 .
29	Kreu VIII, pika 20	Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore në periudhën 19 - 23 tetor 2026 . Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe, brenda datës 30 tetor 2026 .
KREU IX PRANIMET NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV”		
30	Kreu IX, pika 1	Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv” bëhen pranë sekretarive mësimore të njërive kryesore, në IAL-të, deri më datë 05 tetor 2026 .
31	Kreu IX, pika 2	Brenda datës 16 tetor 2026 , IAL-të shpallin dhe afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njërive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara

		nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
32	Kreu IX, pika 4	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve përkatësisht deri më 9 nëntor 2026 .
33	Kreu IX, pika 5	IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 13 nëntor 2026 .
34	Kreu IX, pika 12	Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët deri në 06 tetor 2026 .

REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
AKADEMIA E SIGURISË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 51 Prot.

Tiranë më, 29 / 04 / 2026

VENDIM

Nr. 40, datë 29 . 04 . 2026

PËR

**PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË “BACHELOR” DHE
CIKLIN E DYTË “MASTER PROFESIONAL” E “MASTER SHKENCOR” PËR VITIN
AKADEMIK 2026 – 2027**

Bazuar në nenin 48 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ; pika 22 e VKM-së nr.881 datë 28.10.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, i ndryshuar;

Në vlerësim të planifikimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

Bordi i Administrimit i Akademisë së Sigurisë në mbledhjen e datës 29/04/2026, pasi shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe vlersoi kapacitetet infrastrukturore të Akademisë së Sigurisë;

VENDOSI :

1. Të miratojë 60 (gjashtëdhjetë) kuota për pranimet në programin e studimit në ciklin e parë bachelor (Siguria dhe Hetimi), për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
2. Të miratojë 20 (njëzet) kuota për pranimet në ciklin e dytë “Master Shkencor” në “Siguri publike dhe Hetim krimi”, për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
3. Të miratojë 20 (njëzet) kuota për pranimet në ciklin e dytë “Master Profesional” në “Rendi dhe Siguria publike”, për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
4. Të miratojë 20 (njëzet) kuota për pranimet në ciklin e dytë “Master Profesional” në “Hetim krimi”, për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

Sekretaria të protokollojë këtë vendim, administrojë dhe një kopje t’i dërgohet Senatit Akademik në Akademisë së Sigurisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I AKADEMISË SË SIGURISË

KRYETAR
Sokol BIZHGA



**AKADEMIA E SIGURISE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 142 Prot.

Tiranë më 29.04.2026


VENDIM
Nr. 142, date 29.04.2026

“Për miratimin kuotave të regjistrimit për në programin “Bachelor” dhe “Master Profesional” për vitin akademik 2026-2027

Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë i mbledhur sot më datën 29.04.2026, mbasi diskutoi, në lidhje me kuotat e pranimit në programin e ciklit të parë “Bachelor”, në programin “Master i shkencave” në “Siguri publike dhe Hetim krimi” dhe “Master Profesional”, për vitin akademik 2026-2027, duke marrë në konsideratë kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të PSH si dhe vendimin e Bordit të Administrimit të Akademisë së Sigurisë, në respektim të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe statutin e Akademisë së Sigurisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotës për 60 (gjashtëdhjetë) studentë të cilët do të pranohen në ciklin e parë “Bachelor”, në programin “Siguria dhe Hetimi”, për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
2. Miratimin e kuotës për 20 (njëzet) studentë të cilët do të pranohen në ciklin e dytë “Master i shkencave” në “Siguri publike dhe Hetim krimi” për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
3. Miratimin e kuotës për 40 (dyzet) studentë të cilët do të pranohen në ciklin e dytë “Master Profesional” 20 studentë në “Rendi dhe Siguria publike” dhe 20 studentë në “Hetim krimi” për vitin akademik 2026-2027, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.



Tiranë 29.04.2026



AKADEMIA E SIGURISE
+SENATI AKADEMIK

Nr. 186 Prot.

Tiranë më 29.04.2026

VENDIM

Nr. 143, datë 29.04.2026

“Për miratimin e kriterëve të përgjithshme të pranimit të studentëve, në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Siguria dhe hetimi”, në Akademinë e Sigurisë”

Në mbështetje të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH” nenit 37, 38 dhe 43; nenit 38 të ligjit nr. 82 /2024 “Për Policinë e Shtetit”; nenet 22 dhe 50 të Statutit të Akademisë së Sigurisë; nenin 23 të Rregullores së Akademisë së Sigurisë; dhe propozimit të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit; Senati Akademik:

VENDOSI:

Në programin e studimeve “Bachelor” për Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, të pranohen të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

A) Kriteret të Përgjithshme:

1. Të ketë shtetësi shqiptare;
2. Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit (vetëm për kandidatët nga PSH), struktura të tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil;
3. Të ketë zotësi për të vepruar;
4. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore;
5. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur ose ekuivalentuar nga MAS e RSH;
6. Të zotërojnë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
7. Të mos jete i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
8. Të ketë filluar procedurën për tu paisur me dëshmi aftësie për drejtimin e automjetit të tipit “B”;
9. Të plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe të integritetit;

B) Kriteret të veçanta:

1. Të ketë përfunduar maturën shtetërore sipas mesatares së përcaktuar në VKM.
2. Të jetë në moshën jo më shumë se 30 vjeç në ditën e fillimit të vitit akademik.

3. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkuj dhe jo më pak se 160cm për femra.

Kryetari i Senatit
Prof. Dr. ~~Ilir~~ ANDRO



Tiranë 29.04.2026

KALENDARI I APLIKIMIT UNIVERSITAR 2026

RAUNDI I

3 → 26
KORRIK KORRIK
PAGESA E TARIFAVE
Kohëzgjatja 24 ditë

27 → 1
KORRIK GUSHT
APLIKIMI ONLINE
- PËRZGJEDHJA E
10 PROGRAMEVE
TË STUDIMIT -
Kohëzgjatja 6 ditë

22
GUSHT
PUBLIKIMI I
RENDITJES SË
APLIKANTËVE
NË U ALBANIA
Kohëzgjatja 1 ditë

RAUNDI II

30 → 17
GUSHT SHTATOR
PAGESA E TARIFAVE
Kohëzgjatja 19 ditë

15 → 17
SHTATOR SHTATOR
APLIKIMI ONLINE
- PËRZGJEDHJA E
10 PROGRAMEVE
TË STUDIMIT -
Kohëzgjatja 3 ditë

23
SHTATOR
PUBLIKIMI I
RENDITJES SË
APLIKANTËVE
NË U ALBANIA
Kohëzgjatja 1 ditë

24 → 25
GUSHT GUSHT
ANKIMIMI
Kohëzgjatja 2 ditë

26 → 8
GUSHT SHTATOR
REGJISTRIMI NË IAL /
PUBLIKIMI NË
KOHË REALE I
RENDITJES
(7 FAZA 48 ORËSHE)
Kohëzgjatja 14 ditë

9
SHTATOR
ÇREGJISTRIM NGA
RAUNDI I PARË
NË IAL
Kohëzgjatja 1 ditë

25 → 4
SHTATOR TETOR
REGJISTRIMI NË IAL /
PUBLIKIMI NË
KOHË REALE I
RENDITJES
(5 FAZA 48 ORËSHE)
Kohëzgjatja 10 ditë

5
TETOR
ÇREGJISTRIMI NGA
RAUNDI I DYTË
NË IAL
Kohëzgjatja 1 ditë

23
SHTATOR
PUBLIKIMI I
RENDITJES SË
APLIKANTËVE
NË U ALBANIA
Kohëzgjatja 1 ditë

RAUNDI III

4 → 21
TETOR TETOR
PAGESA E TARIFAVE
-PËR KANDIDATËT QË NUK KANË APLIKUAR
NË RAUNDIN 1 OSE RAUNDIN 2-
Kohëzgjatja 18 ditë

8 → 21
TETOR TETOR
APLIKIM PRANË IAL-ëve PAVARËSISHT
APLIKIMEVE NË RAUNDIN 1-2 DHE REGJISTRIMI
NGA SEKRETARITË NË PORTALIN U-ALBANIA
Kohëzgjatja 14 ditë